



unicef 
for every child



Si të flasim rreth

CORONA VIRUS-19

me fëmijët e vegjël



© Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)

Ky material në përmbajtje synon të japë
udhëzime se si mund të flasim rreth
Koronavirusit në mënyrë të thjeshtë, të qartë
dhe bindëse, duke adresuar njëkohësisht
emocionet që fëmijët mund të ndjejnë gjatë
fëmijërisë së hershme.

PËRSE KAQ SHUMË NJERËZ PO FLASIN PËR DIÇKA

Të quajtur **KORONAVIRUS?**

KORONAVIRUS është një familje virusesh që mund t'i bëjë njerëzit të mos ndihen shumë mirë. Viruset janë organizma kaq të vegjël, saqë mund të shikohen vetëm me lente tepër të veçanta që përdoren për të parë gjëra mikroskopike.




Duke qenë se janë shumë të vegjël, ato mund të hyjnë lehtësisht në trup duke bërë që të mos ndihemi mirë.

Koronavirusi e ka marrë emrin nga fjala “korona” që do të thotë “kurorë”, kjo pasi duket se ky virus ka një kurorë në krye.

Koronaviruset kanë ekzistuar për shumë vite, por kohët e fundit në familjen e koronavirusit është shtuar një anëtar i ri i quajtur “koronavirus 2019”, për të cilin askush nuk kishte dëgjuar më parë!

Së bashku do të mësojmë se si transmetohet ndërmjet njerëzve dhe se çfarë bën brenda trupave tanë që na bën të ndihemi keq.

Është kaq i famshëm
pasi sapo është zbuluar!



A MUND TË HYJË BRENDË TRUPIT TIM ?

Po. Por, ai nuk qëndron në ajër. Për t'u përhapur, ai duhet të kalojë nga një person tek tjetri. Kalimi nga njëri tek tjetri quhet "infektim", përmes së cilës virusi transmetohet nga një trup te një tjetër. Koronavirusi nuk mund të hidhet shumë larg, prandaj përdor mënyrat e mëposhtme për t'u përhapur:

Mund të përcillet nga njëra dorë tek tjetra kur njerëzit përshëndeten ose preken. Prandaj, është e rëndësishme që të lani duart mirë e mirë me ujë dhe sapun për aq sa zgjat një këngë. Duart mund të lahen edhe me solucione me bazë alkooli që thahen vetë.



Tani e tutje, nëse dikush afrohet për t'ju takuar përzemërsisht, mund ta përshëndesni me dorë duke shmangur kontaktin. Përshëndetja juaj mund të jetë e përzemërt edhe me gjeste ose me një buzëqeshje!



Prije dhe ngjite

Ai ndodhet në spërklat e pështymës, të cilat kërcëjnë kur flasim, prekemi ose teshtijmë. Nëse shikoni dikë duke u kollitur ose duke teshtirë, qëndroni larg tyre në mënyrë që të mos prekeni prej spërklave.

Prije dhe ngjite



Prije dhe ngjite

Por, ai mund të qëndrojë për ca kohë edhe mbi një tavolinë ose orendi që e ka prekur dikush me virus, duke infektuar kështu dikë tjetër që prek të njëjtat objekte. Por mos u shqetësoni, pasi virusi mund të zhduket nëse objektet pastrohen mirë.

ÇFARË NDODH NËSE HYN NË TRUPIN TIM?

Mund të mos ndiheni shumë mirë, do ndiheni njëlloj sikur të jeni ftohur. Mund të keni pak temperaturë, kollë dhe mund të keni pak vështirësi në frymëmarrje.

Por, sikurse herët e tjera kur keni qenë sëmurë, pas disa ditësh do të ndiheni më mirë dhe do të luani

sërisht! Pothuajse të gjithë personat ndihen sërisht mirë pas disa ditësh.

Personat që kujdesen për ju do t'ju ruajnë dhe do t'ju mbrojnë.



Ja përse të rriturit ndjekin lajmet për koronavirusin e ri. Ata po mësojnë se si të kujdesen për ju dhe se si t'ju mbrojnë që të mos sëmurëni.

Nëse nuk ndiheni mirë, ata do të kujdesen që të Shërohenisa më shpejt.

Dhe nëse keni qëndruar pranë dikujt të sëmurë me koronavirus, do t'ju duhet të qëndroni në shtëpi për disa ditë edhe nëse ndiheni mirë. Vetëm kështu të rriturit mund të kujdesen më mirë për ju nëse filloni të ndiheni keq, por edhe të mos e lejojnë virusin të vazhdojë të kalojë te fëmijët e tjerë.

Për disa ditë, do t'ju duhet të mungoni në çerdhe ose në kopsht. Kjo gjë mund të mos t'ju pëlqejë, por është e rëndësishme pasi në këtë mënyrë mund të mbroheni nga infektimi.





Prit dhe
ngjit

Gjatë kësaj kohe, ka shumë shkencëtarë që po punojnë për të ndaluar përhapjen e virusit, si dhe po kërkojnë vaksina që të

Bisedoni me të rriturit që kujdesen për ju dhe pyesni për çdo gjë që nuk dini.

ÇFARË KE PARË OSE DËGJUAR PËR KORONAVIRUSIN ?

Mund të vizatoni atë që keni parë ose mund të kërkonit ndihmën e një të rrituri për ta shkruar.

A JENI TË MËRZITUR

NGA KORONAVIRUSI ? Nëse po, qarkoni se sa jeni mërzitur.



Nuk jam
mërzitur



Jam mërzitur

KENI NDJERË EMOCIONE TË TJERA




Është normale që të ndihemi të trishtuar, ankthiozë, të përhumbur, të frikësuar ose të zemëruar kur gjërat ndryshojnë kaq shumë.

Mund të vizatoni atë që keni parë ose mund të kërkoni ndihmën e një të rrituri për ta shkruar.

Çdo gjë që keni ndjerë dhe ndjeni është krejtësisht normale.

Është diçka normale që të ndiheni kështu kur shikoni të rriturit të shqetësuar për diçka ose kur ju kërkohet të mos bëni më diçka si më përpara.


Shpeshherë, ka disa lloje sëmundjesh që mund të prekin shumë njerëz. Ajo që ka më shumë rëndësi është se të rriturit janë pranë jush për t'ju mbrojtur.



Ngjyros

Dhe mos harroni, mund të ndihmoni në parandalimin e përhapjes së virusit duke larë duart dhe duke ndjekur këshillat e tjera që ju kemi dhënë!

PRIJE DHE NGJITE



Prijini figurat duke ndjekur vijat e ndërprera dhe ngjitini në faqet e shënuara.

